

Pajisja me pasaportë biometrike dhe kartë identiteti shqiptare

Për të marrë shërbime pranë Zyrës Konsullore Athinë, ju duhet të kryeni paraprakisht kërkesën elektronike nëpërmjet platformës digjitale www.e-albania.al.

Theksojmë se aplikimi elektronik mund të kryhet individualisht nga telefoni juaj celular/tablet ose kompjuteri juaj personal dhe ka zero kosto.

Më poshtë gjeni informacion shpjegues mbi mënyrën dhe hapat të cilat duhet të ndiqni për kryerjen e aplikimit elektronik në www.e-albania.al:

Hapi i parë: klikoni REGJISTROHU

Regjistrimi i qytetarit në portalin e-albania kryhet me numrin personal (kodin e përdoruesit). Numrin personal mund t'a gjeni në çdo dokument tuajin zyrtar (pasaportë, kartë identiteti, certifikatë). Nëse nuk dispononi kartë ID ose karta e identitetit ka skaduar regjistrimi kryhet me numrin personal që do të mund të gjeni në pasaportën aktuale në faqen e të dhënave (poshtë djathtas) ose në certifikatat tuaja shqiptare.

- Nëse regjistrimi nuk është kryer, hyni në portalin e-albania.al dhe klikoni “Regjistrohu”
- Shkruani tekstin ne CAPTCHA për të provuar që jeni person dhe jo robot dhe klikoni butonin "Vazhdo" ;
- Plotësoni të gjitha të dhënat e kërkuara;
- Kodi i përdoruesit (NID): Vendosni numrin e identifikimit i cili gjendet në pasaportën biometrike/kartën ID/certifikatën tuaj, psh. H12345678J ;
- Fjalëkalimi: Nuk duhet të përmbajë emrin tuaj;
- E-mail: Vendosni adresën e postës suaj elektronike, pasi do ju nevojitet për shërbimet e ardhshme;
- Telefoni: Duhet të përmbajë prefiksin, 003069xxxxxxx;
- Emri, atësia, mbiemri: Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile. *Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç" ;
- Pyetja e sigurisë: Përzgjidhni një pyetje sigurie dhe mbani mend përgjigjen, pasi do ju vlejë në rast se harroni fjalëkalimin ;
- Në përfundim të regjistrimit do t'ju vijë një kod me 4 shifra në e-mailin tuaj dhe një link për aktivizimin e llogarisë suaj në e-albania. Vendosni kodin në rubrikën ku ju kërkohet si dhe aktivizimin e llogarisë nga e-maili juaj. Në përfundim të këtij procesi do t'ju vijë një mesazh elektronik për regjistrimin e kryer me sukses.

Hapi i dytë: klikoni "HYR"

- Klikoni “Hyr” dhe identifikohuni si “Qytetar”;
- Vendosni kodin e përdoruesit (NID) si dhe fjalëkalimin e krijuar;
- Kërko shërbimin: Aplikim për kartë identiteti dhe pasaportë;
- Përzgjidhni opsionin “Aplikim për pasaportë dhe kartë identiteti (për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve)” ;
- Krijë aplikim të ri: Mbushni rubrikat e paplotësuara dhe në fund ngarkoni foton e pasaportës suaj aktuale ose denoncimit të policisë në varësi të rastit (humbje/vjedhje/sekuestrim) ;
- Përzgjidhni datën dhe orën tuaj të takimit;
- Apliko: Në përfundim të aplikimit do ju vijë një kod shumëshifror, psh. 03ATxxxxxxx, së bashku me datën dhe orarin e caktuar nga ju, si dhe numrin e rradhës të gjeneruar nga sistemi;

Sjellim në vëmendjen tuaj dhe njëherë se aplikimi kryhet individualisht dhe pa kosto. Në rast pamundësie ose mungese njohurish në fushën e internetit, ju mund të kërkontë asistencë pranë Ambasadës ose nga të afërmit tuaj të cilët kanë njohuri. Aplikimi nuk është i vështirë. Shmangni rritjen fiktive të koston së shërbimit që merrni, duke kryer pagesa të panevojshme për kryerjen e aplikimit.

Për çdo paqartësi mos hezitoni të na kontaktoni në adresën tonë elektronike consulate.athens@mfa.gov.al.

Kush aplikon

Ka të drejtë të aplikojë për pasaportë biometrike çdo shtetas shqiptar i regjistruar në zyrat e gjendjes civile në Shqipëri. Çdo shtetas shqiptar deri në moshën 16 vjeç, aplikon vetëm për pasaportën biometrike të vlefshme për 5 vjet.

Çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 16 vjeç dhe nuk ka aplikuar apo ka më shumë se një vit nga data e aplikimit pa tërhequr kartën e identitetit është i detyruar, që ditën që paraqitet në Ambasadë, të aplikojë njëkohësisht për pasaportë biometrike dhe për kartë identiteti me afat vlefshmërie 10 vjet.

Dokumentat që duhet të keni me vete për aplikim

Shtetasit shqiptarë 0-16 vjeç, duhet të paraqiten personalisht përpara Konsullit të shoqëruar nga të paktën njëri prind (ose ai që e ka në ngarkim kur prindërit janë të ndarë apo të pamartuar), i cili duhet të ketë me vete pasaportën/kartën e identitetit, dhe pasaportën (e skaduar apo të pavlefshme) të femijës, *ose kur nuk ka*, një çertifikatë personale të femijës me fotografi të lëshuar tre muajt e fundit nga zyra e Gjendjes Civile në Shqipëri.

Shtetasit madhore me moshë mbi 16 vjeç

Shtetasit madhore me moshë mbi 16 vjeç aplikojnë duke u paraqitur personalisht përpara Konsullit, me dokumentat e mëposhtme:

- Pasaportën e skaduar, të dëmtuar, të pavlefshme, dhe/ose
- Kartën e identitetit
- Kur aplikojnë për herë të parë për pasaportë biometrike duhet patjetër të kenë me vete dhe një çertifikatë personale\lindje
- Një dokument grek identifikimi me fotografi

Sipas Udhëzimit nr. 289, datë 02.09.2020, shtetasi ripajiset me pasaportë, para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese në rastet e mëposhtme:

- 15. a) kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me afatin 6-mujor(gjashtëmujor) të vlefshmërisë së pasaportës. Në këtë rast, pajisja me pasaportë bëhet 6 (gjashtë) muaj përpara;
- b) kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile;
- c) kur pasaportës i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;
- d) kur pasaporta është deklaruar e humbur;
- e) kur pasaporta është kallëzuar e vjedhur;
- f) kur pasaporta është dëmtuar fizikisht.

16. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, për ripajisjen me pasaportë, subjektet paraqesin për identifikim pasaportën ekzistuese.

17. Në rastin e parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, në momentin e aplikimit për t'u ripajisur me pasaportë pranë zyrave të aplikimit, shtetasi plotëson formularin e vetëdeklarimit të humbjes së pasaportës. Për shtetasit që jetojnë jashtë vendit, vetëdeklarimi kryhet në përfaqësitë diplomatike/konsullore. Në çdo rast shtetasi denoncon humbjen e pasaportës në Policinë e Shtetit.

18. Në rastet e parashikuara në shkronjën “e”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, shtetasi në momentin e aplikimit për t'u ripajisur me pasaportë pranë zyrës së aplikimit apo në përfaqësitë diplomatike/konsullore, paraqet dokumentin përkatës, të lëshuar nga Policia e Shtetit.

19. Në rastin e parashikuar në shkronjën “f”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, shtetasi në momentin e aplikimit për t’u ripajisur me pasaportë, duhet të paraqesë pasaportën e dëmtuar. Me pasaportë të dëmtuar kuptohet çdo lloj dëmtimi fizik i këtij dokumenti, që përfshin rastet e mëposhtme:

- a) të dhënat janë të padeshifrueshme;
- b) është çngjyrosur faqja e të dhënave biometrike;
- c) kur ka dëmtime kimike ose me bojë në ndonjë faqe të pasaportës;
- d) kur konstatohet mungesa, grisja ose dëmtimi fizik i ndonjë faqeje të pasaportës;
- e) kur konstatohet dëmtimi i çipit.

Në rast humbje/vjedhje të pasaportës biometrike ose/dhe të kartës së identitetit

Në rast humbje/vjedhje të pasaportës biometrike dhe/ose të kartës së identitetit, shtetasi duhet të paraqitet pranë komisariateve të policisë për të denoncuar humbjen ose vjedhjen.

Sqarojmë se:

-Vërtetimi/denoncimi duhet detyrimisht të mbajë emrin mbiemrin e mbajtësit të dokumentit dhe numrin e dokumentit (pasaportës dhe\ose kartës së identitetit)

-Vërtetimi/denoncimi pasi tërhiqet nga zyrat e policisë greke duhet vulosur nga drejtori i Policisë (Diefthintis)

-Vërtetimi/denoncimi *vulose* me VULE APOSTILE në Periferian e qyteteve/rretheve nga ku është lëshuar. Për informacion lidhur me Zyrat ku merret vula Apostile, klikoni në lidhjen që jepet prezent <https://assets.hcch.net/docs/cc3ac3f9-737f-4749-95b6-408275d59a76.pdf>

-Vërtetimi/denoncimi duhet përkthyer në gjuhën shqipe, nga një përkthyes i licencuar ose nga Zyra e Përkthimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme Greke

Në rast të një pasaporte të sekuestruar nga autoritetet greke

Në rast të një pasaporte të sekuestruar nga autoritetet greke, dorëzohet në Ambasadë procesverbali i sekuestrimit, i cili njësoj si denoncimi duhet të ketë emrin mbiemrin dhe numrin e pasaportës, si dhe të ndiqet e njëjta rrugë për apostilimin e tij.

Shënim: Dokumenti origjinal i legalizuar i humbjes/vjedhjes apo i sekuestrimit dorëzohet në Ambasadë ditën e aplikimit.

Procesi i aplikimit është i njëjtë me atë që kryhet edhe në zyrat e aplikimit në Shqipëri.

Kur mund të aplikoni

Orari i aplikimit: Çdo ditë nga e hëna deri të premten nga ora 09:00-14:30

Tarifa e shërbimit

Për lehtësimin e procedurave dhe për t’iu ardhur në ndihmë qytetarëve, pagesa për rinovimin e pasaportave biometrike dhe kartave ID, si dhe shërbimeve të tjera bëhet në ambientet e Zyrës Konsullore, me mënyrat si më poshtë:

1. Me çdo lloj kartë bankare nëpërmjet aparaturave POS të instaluar në Zyrën tonë Konsullore

2. Me kartëmonedha (CASH) në bankomatën pranë Zyrës Konsullore, të përshtatur edhe në gjuhën shqipe
3. Nëpërmjet transaksioneve online (me provën e pagesës)

Tarifa konsullore për pasaportë është 130 euro. Tarifa konsullore për pasaportë dhe kartën e identitetit është 142 euro

Kur tërhiqet dokumenti biometrik

Dokumentat biometrike mund të tërhiqen jo më shpejt se tre javë nga data e aplikimit dhe jo më vonë se një vit. Pasi kalon një vit nga data e aplikimit dokumentat e patërhequr asgjësohen.

Kush e tërheq dokumentin biometrik

Për tërheqjen e dokumenteve biometrike mund të paraqiteni pranë sporteve të Zyrës Konsullore nga e hëna deri të premten, ora 09:00-14:30 ose të na kontaktoni në adresën tonë të e-mail-it consulate.athens@mfa.gov.al për t'ju ofruar opsionin e dërgesës së tyre përmes shërbimit postar.

Tërheqja e pasaportës kryhet nga shtetasi ose i ngarkuari me autorizim nga KEP (jo fotokopje ose fax) apo një pjestar i afërt i familjes sipas certifikatës familjare (bashkëshorti, prindi, fëmija madhor), apo një kujdestar ligjor për të miturit dhe për shtetasit pa zotësi për të vepruar.

Dokumentat që duhet të paraqisni për të tërhequr dokumentin biometrik

- Faturën e aplikimit
- Pasaportën e prerë ose kartën e identitetit
- Familjarët duhet të kenë një dokument identifikimi
- I ngarkuari me prokurë duhet të ketë, prokurën dhe një dokument identifikimi
- Kujdestari ligjor duhet të ketë vendimin e gjykatës dhe një dokument identifikimi